

## KRITIKË E BIBLIOGRAFI

*Dalan Shaplo: Letërsia dhe realiteti ynë, Tiranë 1968, 210 f.*

Vitet e fundit u karakterizuan nga një gjallërim dhe aktivizim i veçantë i mendimit kritik, që dëshmon se kritika jonë përpiqet të kapërcejë prapambetjen që e dallon në krahasim me letërsinë, dhe po ecën me hapa të shpejta drejt pjekurisë së vet.

Brenda kësaj kohe janë botuar mjaft përmbledhje me artikuj kritikë, që ndalen mbi probleme dhe autorë të ndryshëm të letërsisë sonë.

Një prej tyre është vëllimi i D. Shaplos «Letërsia dhe realiteti ynë» ku autori ka kapur probleme interesante të letërsisë sonë dhe është përpjekur të hedhë dritë mbi tiparet kryesore të individualitetit krijues të disave nga autorët tanë më të mirë. Në këtë vëllim janë përmbledhur artikuj të ndryshëm të botuar në shtypin tonë. Pjesa e parë e vëllimit përmban artikuj me karakter të përgjithshëm, ku trajtohen disa probleme të letërsisë sonë.

Artikujt që e hapin vëllimin «Probleme ideore dhe artistike të poezisë sonë» dhe «Zhvillimi i mëtejshëm i poezisë, forcimi i përmbajtjes së saj», duke plotësuar njëri-tjetrin, synojnë të japin një pasqyrë të zhvillimit të poezisë sonë gjatë viteve të fundit.

Në artikullin e parë D. Shaplo vë re disa tipare të poezisë sonë të viteve të fundit si forcimi i realizmit apo afrimi i epikës me lirizmin.

Mbi tiparin e parë autori ndalet më gjatë, dhe e trajton problemin duke iu përmbajtur një kuptimi të gjerë, për realizmin që nuk e merr atë si një parim të caktuar të pasqyimit artistik të jetës por e lidh me «konceptimin e jetës në lëvizje, me pohimin e fuqishëm me plot gojën të realitetit duke e bërë atë jo me stil emfatik dhe retorik, po me një thellësi më të madhe mendimi dhe me një paraqitje më konkrete të jetës», tipare këto që nuk janë specifike vetëm për realizmin si të tillë.

Një koncept i tillë shfaqet në shprehjet e papërcaktuara «notat e realizmit», «konceptimi jo gjer në fund realist i brendisë dhe i formës» dhe e shtyn autorin të kërkojë një ndarje të prerë midis realizmit në prozë dhe realizmit në poezi, duke hedhur mendimin për një realizëm në specifikën e poezisë që, sipas tij, duhet të dallohet nga një forcë sintetike më e madhe, nga kapja e momenteve kulminante të veprimit, duke i lënë mënjanë hollësitat e tjera dhe duhet të shkrihet me frymën romantike». Kritiku mendon se në poezi nuk mund të kërkohej një realizëm i tillë si në prozë me konflikte të thelluara, ndeshje karakteresh, luftë të kundërtave dhe se «poeti duke i vënë për detyrë vetes që të jetë realist nuk duhet të synojë në krijimin e karaktereve me mjetet e prozës, se kështu nuk bëjmë tjetër veçse mbetemi në shembujt e një poezie epike të vjetëruar(!).»

Për mendimin tonë veçoritë që, sipas D. Shaplos, e dallojnë realizmin në poezi nuk janë specifike as për poezinë, as për realizmin. Mos vallë forca sintetike nuk mund të dallojë edhe prozën? Dhe a nuk mund të jetë kjo forcë sintetike

karakteristike edhe për një vepër romantike? Kurse romantika si botë ideoemocionale nuk ka të bëjë me parimin e pasqyrimin të jetës.

Nga ana tjetër, tingëllon e pajustificuar kërkesa që në poezi të mos ketë konflikte të thelluara dhe luftë të kundërtave dhe shprehja «krijimi i karaktereve me mjetet e prozës» mbetet e paqartë ashtu si aluzioni për «një poezi epike të vjetëruar».

D. Shaplo bën objekt vëmendjeje edhe problemin e novatorizmit dhe të traditës në poezi. Ai kërkon me të drejtë që novatorizmi të shihet në radhë të parë si një çështje e brendisë, duke theksuar se «materiali i jetës, idetë e kohës, mendimi revolucionar janë primare në unitetin e përmbajtjes me formën» dhe se «asnjë novacion, asnjë zell për figura e për ndjenja të holla nuk duhet ta largojë poezinë nga perspektiva e ideve të marksizëm-leninizmit». Po ai nuk lë pa vlerësuar dhe rolin aktiv të formës në raport me përmbajtjen.

Duke folur për raportin midis novatorizmit dhe traditës, autori dënon si format e vjetëruara të cilave u ka kaluar koha ashtu edhe «eksperimentet e papërligjura formale që nuk nisen nga një ide e rëndësishme». D. Shaplo thekson se veçanërisht e rëndësishme për ecjen përpara të poezisë është lufta kundër rutinës duke vënë në dukje se përveç rutinës së vjetër në poezi po formohet një rutinë e re, po aq e dëmshme sa e para. Kritiku prek çështjen aq të diskutuar të vargut të lirë e vargut të rregullt dhe përpiqet të gjejë anët pozitive e negative të këtyre dy formave. Autori i sheh këto të lidhura ngushtë me talentin e secilit poet dhe thekson se «formimi i stilit, konsequenca e rrugës poetike në vijat e përgjithshme është e rëndësishme për çdo artist» dhe poetët duhet, në radhë të parë, t'i qëndrojnë besnikë vetvetes. Kritiku u kushton vëmendje individualiteteve krijuese të veçanta duke u munduar të përcaktojë tiparet e tyre.

D. Shaplo bën përpjekje të tregojë edhe zhvillimin e brendshëm të llojeve të poezisë. Ai vë re si një fenomen interesant vendin e madh që ka filluar të zërë në poezinë tonë lloji i poemës liriko-epike pa subjekt të caktuar, lloj që ai e quan «poemë sintezë». Ndërsa në lirikën qytetare dhe në lirikën intime ai vë re një pjekuri më të madhe që sipas tij shfaqet në të parën «në një konkretësi më të madhe... dhe në një karakter... më të theksuar filozofik e meditativ» dhe në të dytën në një pasqyrim më të qartë të botës shpirtërore të njeriut të ri dhe në një afrim me temën e kohës.

Po autori mjaftohet këtu me konstatime, duke mos i kërkuar shkaqet që përcaktojnë mbizotërimin e një lloji të caktuar ose veçoritë e një lloji tjetër.

D. Shaplo i jep një rëndësi të veçantë luftës për thjeshtësi artistike, të cilën nuk e ngatërron me thjeshtëzimin e uljen e poezisë.

Ai merret edhe me probleme ideore siç janë detyra që qëndron para poezisë për t'ju përgjigjur sa më shpejt temës së ditës, për të pasqyruar sa më thellë njeriun tonë, problemi i mënjanimit të disa shfaqjeve të botëkuptimit mikrobor-gjez në vjershat, e dashurisë.

Artikullin «Probleme ideore dhe artistike të poezisë sonë e dallon një farë fragmentarizmi, që vjen nga shumëllojshmëria e madhe e problemeve që trajtohen e që shpesh vetëm shtrohen e nuk çohen deri në fund, si edhe nga fakti që autori, duke i ilustruar mendimet e veta me material nga poezia jonë, herë-herë ndalet në çështje që kanë të bëjnë me vepra të veçanta si, bie fjala, pasqyrimi i figurës së popullit në poemën «Përse mendohen këto male».

Për mendimin tonë artikulli, ndonëse ka meritën e shtrimit të shumë problemeve me interes dhe aty-këtu vëzhgime të goditura, nuk ka arritur të zbulojë plotësisht tiparet dhe rrugët e zhvillimit të poezisë sonë.

Disi fragmentar dhe jo shumë i qartë është edhe artikulli «Zhvillimi i mëtejshëm i poezisë, forcimi i përmbajtjes së saj» që ngjan si një plotësim i të parit, ku i kushtohet vëmendje kryesisht problemit të pasurimit në brendi të poezisë sonë,

duke vënë në dukje sukseset dhe të metat në këtë drejtim, duke i ilustruar përmes analizës së ndonjë krijimi të veçantë më tipik. Edhe këtu autori përpiqet të zbulojë tipare të poezisë sonë të viteve të fundit. Ai mendon se tipare të tilla janë forcimi i epizmit dhe qartësia më e madhe, po nuk e argumenton këtë mendim të tij duke e parë poezinë tonë në zhvillim.

Ai ngrihet kundër kërkimeve formaliste që e errësojnë mendimin në vend që ta qartësojnë atë dhe shprehet për një lidhje më të madhe të poezisë me traditën kombëtare, për një shfrytëzim më të madh krijues të folklorit tonë, po nuk e shtjellon deri në fund mendimin e tij.

Më të përgjithshëm janë artikujt «Letërsia dhe realiteti ynë», «Përmbajtje e thellë dhe formë e lartë» dhe «Temat e mëdha të aktualitetit».

Në të parin autori trajton problemin e njohjes dhe të pasqyrimin të jetës në letërsinë tonë dhe vë re se ka shumë aspekte të rëndësishme të jetës sonë që kanë mbetur jashtë pasqyrimin artistik.

Duke kërkuar nga letërsia një pasqyrim më të gjerë e më të thellë të realitetit, kritiku bën diferencimin në këtë drejtim sipas gjinisë dhe individualitetit krijues të autorit.

Në artikull preket edhe problemi i interpretimit të botës në dritën e botëkuptimit marksist-leninist, po autori vetëm sa e shtron pa u ndalur hollësisht në të.

Te «Përmbajtje e thellë dhe formë e lartë» D. Shaplo, duke e trajtuar përmbajtjen në unitet me formën, kërkon një theksim të frymës popullore, një pasqyrim më të mprehtë të luftës së klasave si edhe një pasurim të formës, të mjeteve artistike të gjuhës.

Në artikullin «Temat e mëdha të aktualitetit» paraqesin interes mendimet e autorit lidhur me pasqyrimin e heroizmit. Kritiku ngre këtu problemin e raportit midis heroit dhe masës në veprat tona letrare, problemin e raportit midis heroikës dhe së jashtëzakonshmes si edhe problemin e vështrimit të thellë dialektik të botës shpirtërore të heroit. Autori me të drejtë mendon se heroizmi nuk duhet parë vetëm në gjestet e jashtëzakonshme. Nga ana tjetër, ai thekson se, duke folur për heronjtë e vdekur, duhet të ruhem nga skemat që e minimizojnë dhimbjen e natyrshme njerëzore si edhe nga simbolet e trashëguara nga letërsia e mëparshme që lidhen me idenë kristiane të pavdekësisë dhe mund t'i japin veprës një tingëllim të gabuar ideor.

Pika kontakti me artikujt e mëparshëm ka artikulli «Një vit letërsi në rrugën e realizmit socialist», ku autori i hedh një vështrim të përgjithshëm krijimtarisë letrare në vitin 1964, duke nxjerrë disa probleme që i duken më tipike.

Më i thellë dhe më i plotë është artikulli «Për një pasqyrim të shumanëshëm të jetës në prozë», ku jepen disa mendime rreth disa problemeve të rëndësishme të prozës sonë.

Në radhë të parë, autorin e shqetëson problemi i heroit pozitiv. Ai vë re si sukses në këtë drejtim një rritje të thellësisë në pasqyrimin e karaktereve, ndërsa si të meta sheh mungesën e individualiteteve të qarta të gdhendura mirë, mungesën e motivimeve bindëse të veprimeve të heronjve. Ai mendon se rrugët për t'i kapërcyer këto të meta janë njohja më e mirë e karaktereve dhe të shmangurit nga uniformiteti. Këto për mendimin tonë kritiku ka shkëputur dy anë të të njëjtit fenomen përderisa vetë uniformiteti, skematizmi rrjedh nga mosnjohja e jetës dhe e karaktereve.

D. Shaplo nuk ndalet gjatë në trajtimin e problemit të heroit, po hidhet në problemin e novatorizmit në prozë në fushën e formës. Ai prek çështjen e të ashtuquajturit «stil të sotëm» po nuk mban ndaj këtij problemi qëndrim të qartë e të prerë. Megjithëse pranon se s'mund të ketë një stil të përbashkët të kohës, se kryesore në përcakimin e formës janë pozita ideologjike dhe individualiteti i shkrimtarit ai, duke përshëndetur kërkimet në formë të disa romancierëve si

P. Marko, A. Abdihojha, hedh mendimin se ritmi më i vrullshëm i jetës duhet të përcaktojë «një dinamizim të ritmit të brendshëm të veprave letrare», ose, me fjalë të tjera, një mbizotërim të veprave që e pasqyrojnë jetën në mënyrë të ngjeshur. Na duket se një mendim i tillë është tepër kategorik dhe bie në kundërshtim me domosdoshmërinë e larmisë së individualiteteve krijuese në letërsinë tonë të realizmit socialist.

Te artikulli «Të forcojmë qëndrimin ideologjik në tregimet tona, të pasqyrojmë brendinë e tyre» autori ka ditur të shohë disa prirje pozitive, ende jo të kristalizuara në atë kohë në tregimin tonë si trajtimi më i madh i temës së punës, zbulimi i njeriut të ri në qëndrimin e tij ndaj punës, interesimi më i madh për temën e heroizmit, ka ditur të shohë gjithashtu disa prirje negative si trajtimi i problemit të dashurisë nga pozita meskine mikroborgjeze që vihej re në tregimet e D. Agollit, A. Cergës ose theksimi i anës së dhimbshme të luftës në dëm të frymës heroike që u shfaq në tregimin tonë si rezultat i presionit të madh të letërsisë revizioniste.

Po mendojmë se me këto prirje të gabuara ideore duhet të lidheshin tregimet e I. Kadaresë «Përbindshi» dhe «Zbërthimi», të cilat kritikohen vetëm nga ana e formës, e konvencionalizmit të theksuar, e përzjerjes pa vend të fantastikes me realen; këtu mendojmë se kritiku pa të drejtë ka parë si primare formën duke gjetur tek ajo burimin e të metave të theksuara në pasqyrimin e realitetit që kanë tregimet në fjalë. Sipas mendimit tonë në ato tregime ka qenë pikërisht interpretimi jo i drejtë ideor i jetës që ka përcaktuar errësinë e formës, teprimin në simbole e konvencione.

Pjesa e dytë e vëllimit të D. Shapllës përmban tetë punime që u kushtohen autorëve dhe veprave të veçanta të letërsisë sonë. Mendojmë se në përgjithësi këto punime qëndrojnë më lart se sa ato që u kushtohen problemeve të përgjithshme.

Edhe këtu spikasin si më të realizuara punimet që trajtojnë veprat poetike. Ndofta që këndej mund të nxirret konkluzioni se D. Shapllë shquhet më tepër si kritik i poezisë.

Me dashuri e kujdes janë shkruar artikujt «Rruga e një poeti», «Vargje për shekullin dhe për Shqipërinë», «Lirizëm dhe natyrshmëri poetike».

«Rruga e një poeti» paraqet interes si një përpjekje për një analizë tërësore të krijimtarisë së njërit prej poetëve tanë më të njohur si edhe për faktin se në kritikën tonë punime të këtij lloji mungojnë ende.

Autori, duke e parë krijimtarinë e Ll. Siliqit në zhvillim, në tërë zig-zaget, ngjitjet e zbritjet e veta, duke u mbështetur në krijimet më të goditura, ka arritur të zbulojë tiparet kryesore të stilit të këtij poeti si poet i lirikës qytetare, që tërhiqet më tepër nga problemet e mëdha politike, nga një herë edhe shoqërore e morale, si poet «i planit të gjerë, i ngjyrave të forta, i fjalës që lavdëron e godet hapët», tipare që kanë përcaktuar edhe ritmin dinamik të poezisë së tij, që karakterizohet në përgjithësi nga vargu i thyer.

Kritiku ndjek procesin e formimit të personalitetit artistik të Ll. Siliqit, duke vënë re ndikimet që kanë luajtur rol në këtë formim.

Analiza e hollësishme e zhvillimit të individualitetit krijues të këtij poeti i ka dhënë mundësi autorit të shquajë edhe dobësitë në krijimtarinë e Siliqit.

Kritiku i trajton këto dobësi duke bërë dallimin midis atyre që rridhnin nga pjekuria e pamjaftueshme ideore dhe artistike, atyre që kanë qenë bashkëudhëtarë të përkohshme të tërë letërsisë sonë në një periudhë të caktuar dhe atyre prej të cilave poeti nuk është çliruar ende.

Me të drejtë D. Shapllë pohon se lloji i poemës që i përshtatet më tepër talentit të Ll. Siliqit është lloji liriko-epik, e ashtuquajtura «poemë sintezë» dhe vlerëson si kulme të krijimtarisë së këtij poeti poemat «Prishtina» dhe «Ringjallje». Veçse këtë mendim të tij ai nuk e lidh me të metat që kritikon te «Mësuesi» apo «Erë

pranverore», duke mos i parë këto të meta si rrjedhim të mospërputhjes së llojit të poemës narrative me talentin e Ll. Siliqit.

Shpjegimi i këtyre të metave siç bën kritiku me shtrirjen dhe ndërlikimin e subjektit na duket pa baza. Mendojmë se jo shtrirja e subjektit në një mënyrë që sipas D. Shapllës është më e përshtatshme për prozën, po ndërhyrjet e tepruara lirike vend e pa vend të poetit i kanë dëmtuar në thelb poemat në fjalë.

Nuk na duket i drejtë edhe pohimi që bën autori lidhur me «Erë pranverore», se mund të ketë poema me subjekt ku të mungojë konflikti. Ky pohim ka të bëjë me sa duket me konceptin e autorit për realizmin në poezi.

Megjithatë D. Shapllë në këtë artikull nuk ka mundur të gjejë vendin e krijimtarisë së Ll. Siliqit në poezinë tonë.

Në artikujt «Vargje për shekullin dhe për Shqipërinë», «Lirizëm dhe natyrshtëri poetike» kritiku i sheh vëllimet e dy poetëve tanë të talentuar I. Kadare dhe D. Agolli «Shekulli im» dhe «Hapat e mia në asfalt» në kuadrin e krijimtarisë së secilit poet dhe në kuadrin e poezisë sonë të atyre viteve me qëllim që të hedhë dritë mbi hapat e poetëve në rrugën e tyre krijuese dhe mbi origjinalitetin e tyre, mbi të renë që sollën ata në letërsinë tonë. D. Shapllë synon të kapërcejë caqet e analizës së një vëllimi konkret dhe të vizatojë edhe profilin e secilit poet. Veçse ai, në qoftë se arrin të vlerësojë në përgjithësi drejt vëllimet që merr në shqyrtim, nuk arrin që të gjejë tiparet specifike të individualitetit krijues të dy poetëve që i bëjnë ata të spikasin në letërsinë tonë. Kështu D. Shapllë e quan I. Kadarenë poet që ka aftësi të kapë shpejt të renë në çdo fushë, ta lartësojë atë me forcë poetike, poet me fantazi të pasur me aftësi të veçantë në krijimin e figurave, ndërsa D. Agollin poet që i trajton fenomenet me thjeshtësi, lirizëm e hera-herës me humor, duke përdorur me sukses detajin artistik. Pa dyshim këto tipare ekzistojnë në krijimtarinë e të dy poetëve, po nuk përbëjnë të veçantën, specifiken që i dallon ata, nuk e japin në mënyrë të plotë individualitetin e tyre.

Interesante është përpjekja e D. Shapllës për ta lidhur si poezinë e I. Kadaresë ashtu edhe poezinë e D. Agollit me prirje të caktuara në poezinë tonë, po edhe këtu kritiku mbetet në shprehje të përgjithshme pa arritur të sqarojë se cilave ligje të brendshme të zhvillimit të poezisë sonë u është përgjigjur talenti i I. Kadaresë apo ai i D. Agollit. Autori pohon se poezia e I. Kadaresë shpreh prirjen për të shkrirë organikisht un-in poetik me problemet, me ngjarjet e rëndësishme të kohës. Lind pyetja: a nuk është kjo prirje karakteristike për tërë poetët e talentuar? Ku qëndron këtu e reja që sollí I. Kadareja?

I paqartë dhe i përgjithshëm është edhe pohimi se poezia e D. Agollit shpreh prirjen drejt «pasqyrimin më të thellë të ndjenjave, të nuancave të tyre përmes un-it poetik, përmes disa portreteve, ku autori mund të zbulojë më mirë vetveten dhe jetën e sotme dhe për mes natyrës të shikuar me një sy të ri».

Me interes është qëndrimi kritik që mban autori ndaj disa dobësive e prirjeve negative që shfaqen në dy vëllimet si disa paqartësi ideore në trajtimin e problemit të luftës e të paqes, të problemeve të moralit ose të artit dhe prirja drejt kërkimit të figurave origjinale në dëm të mendimit në vëllimin e I. Kadaresë dhe dalja në disa raste në sipërfaqe të fenomeneve, momentet e prozaizmit të D. Agolli. Veçse mendojmë se ana kritike në artikujt e lartpërmendur mund të ishte më e fortë. Për këtë do të vlente një rishikim i këtyre artikujve, të shkruar para disa vjetësh, në lidhje me rrugën e mëtejshme krijuese të poetëve që bëhen objekt analize dhe të tërë letërsisë sonë.

Po të bëhej kjo, bie fjala, disa krijime të I. Kadaresë si «Pejsazh gjeneral», «Paqen do ta imponojmë!», të D. Agollit si «Leni, Leni» do të shiheshin të lidhura me prirjen negative për të nënvizuar tmerret e luftës në letërsinë tonë të atyre viteve. Gjithashtu do të vihej re se prozaizmi e ka dëmtuar mjaft vëllimin e D. Agollit «Hapat e mia në asfalt».

Në artikujt «Aromë e fushave dhe e maleve tona», «Mendime për një prozator të talentuar», «Pasqyrimi i tipareve të kohës», «Kënga dhe pushka» D. Shaplllo merret me analizën e vëllimeve të disa tregimtarëve tanë. Në këta artikuj mund të gjenden shumë vëzhgime të goditura. Kritiku është thelluar më tepër në krijimtarinë e S. Andonit së cilës i ka kushtuar dy artikuj që plotësojnë njëri-tjetrin «Aromë e fushave dhe e maleve tona» dhe «Mendime për një prozator të talentuar». Duke e parë këtë autor në zhvillim D. Shaplllo ka arritur të zbulojë tiparet e talentit të tij, të renë që solli ai në llojin e tregimit si edhe ndonjë prirje të dëmshme si teprimi në frymë romantike e arkaizmi.

Të qartë dhe të argumentuar janë edhe dy artikujt për vëllimet e N. Priftit dhe Dh. Shuteriqit, ku kritiku ka dhënë në mënyrë konçize jo vetëm vlerësimin e veprave të caktuara, po disa veçori tipike individuale të dy prozatorëve.

Përkundrazi në të vetmin artikull që i kushtohet një drame «Drama — Hijet e natës» D. Shaplllo nuk ka arritur të zbulojë thelbin e veprës që analizon. Autori jep mendimin se drama në fjalë i përket llojit psikologjik dhe e vlerëson si realiste dhe të goditur duke mbështetur mendimin e vet me analizën e karaktereve të veçantë. Dhe pikërisht duke analizuar këto karaktere D. Shaplllo duhet të kishte vënë re qëndrimin objektivist të autorit, që e dëmton shumë idenë e dramës.

D. Shaplllo quan si karakter që dëshmon për realizmin e dramës figurën e Zehrasë edhe duke e pranuar vetë se «autori nuk na e tregon qëndrimin e saj në lëmin politik, po më tepër në atë moral ose etik» dhe i vesh disa cilësi jo tipike për kategorinë shoqërore që ajo përfaqëson. Në vend që ta shohë këtë gjë si kufizim të realizmit ai e vlerëson si meritë.

Gjithashtu duke analizuar figurën e Halitit e duke vënë re me të drejtë se ai është «një humanist abstrakt, me botëkuptim të ngushtë» kritiku nuk i jep rëndësi qëndrimit të autorit ndaj kësaj figure dhe prandaj nuk arrin ta shpjegojë drejt dobësinë themelore të saj. Kjo vjen, sipas mendimit tonë, nga që kritiku e sheh veprën letrare si pasqyrim të drejtpërdrejtë të karaktereve dhe jo si vlerësim ideologjik të tyre. Duke mos parë në figurën e Halitit idenë e autorit D. Shaplllo nuk arrin dot në konkluzionin se kjo figurë ka dalë e dobët dhe artificiale për shkak të idesë së gabuar të mishëruar në të.

Artikujt e vëllimit «Letërsia dhe realiteti ynë», megjithëse të shkruar me stil të matur e të rrjedhshëm, nuk kanë mundur t'i shpëtojnë sëmundjes nga e cila vazhdon të vuajë kritika jonë — mungesës së qartësisë. Në mjaft raste mendimi humbet në mes të frazeologjisë. Kjo lidhet disa herë me faktin se autori operon me nocione teoriko-letrare të cilave nuk u ka dhënë një brendi të përcaktuar ose me përdorimin e një terminologjie jo të saktë nga pikëpamja shkencore.

Pavarësisht nga këto vërejtje «Letërsia dhe realiteti ynë» ka merita në shtrimin e disa problemeve të rëndësishme të letërsisë sonë dhe në mënyrë të veçantë në vlerësimin e disa individualiteteve krijuese e të veprave që spikasin në letërsinë tonë.

Klara Kodra